

**AKTI I THEMELIMIT TË SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI
TE KUFIZUAR "FORTIS INERT"SH.P.K.**

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, sot, **me dt. 02/11/2022** me vullnet të lirë, Ortakët:

1. **Shoqëria "Fortis Beton CO"shpk**, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L71912018R, me seli në adresën: Tiranë, Vaqarr, Rruga "Leke Zaharia", ambienti me nr. Pasurie 346/15, 346/28, 346/30, 346/32, ZK. 3321, Sharrë, me Administrator z. Ermir Alija;
2. **Z. Elgerti Bixha**, lindur më 15.03.1986, në Vlorë dhe banues në Tiranë, pajisur me letërnjoftimin me nr. 035113156;

si themelues te kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosen të hartojne këtë Akt Themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme:

NENI 2

EMRI

Emri i shoqërisë është "**FORTIS INERT**"shpk.

NENI 3

FORMA

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakët do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nëshkruara për kapitalin.

NENI 4

SELIA

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë, në Rr. "Irfan Tomini", Pallati "Bjorn", Kati 2, Njësia Bashkiake nr. 7.

Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 5

AFATI

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të paktuar.

NENI 6 OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Prodhim e tregtimin e mallrave te ndertimit, materiale inerte, rere, cakull, gure, shfrytezim kariere guri, gurore, tregtim me shumice e pakice dhe import-eksport, mallra te ndryshme industriale, ushqimore, pije, konfeksione, hidro-sanitare, hidraulike, fruta-perime, bime medicinale, eterovajore, paisje elektrike, e elektronike, elektroshtepiake, kinkalери-kancelari, zyre e shkollore, makineri, pjese kembimi per automjete, bateri, goma etj. Transport mallra brenda dhe jashte vendit. Germime dheu ne punime eventuale, murature, e beton arme, prishje dhe punime ne toke te germuar, prodhim materiale inerte, gure, prodhim elemente betoni e beton arme te zakonshme, paranderur gure dekorativ, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore mbi 5 kate, rikonstruksione, ndertim rruge kategoria 5 dhe 4, mbishtresa rrugore, , ura, dhe vepra arti deri me 10 metra, ndertim ujesjellesa, kanalizime, impiante vaditese, perforcim themeli e punime nentokesore, instalim impiante higjenike, kuzhina, lavanderi etj. Instalim i materialve prej druri, metalike, plastike, xhami punime bojatisje, hidroizolim, termoizolim akustike etj. Kryerja e punimeve per sherbesa funebre, objekte civile, industriale, vepra ujitjeje, kullimi, impiante vaditese diga deri ne 10 metra, damba etj.

NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mije) lekë. Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara dhe nënshkruar si më poshtë:

- 1. Shoqëria "Fortis Beton CO" shpk**, në cilësinë e ortakut themelues, zotëron **50%** të kapitalit themeltar, ose 1 kuotë të barabartë me vlerë prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë në kapitalin themeltar.
- 2. Z. Elgerti Bixha**, në cilësinë e ortakut themelues, zotëron **50%** të kapitalit themeltar, ose 1 kuotë të barabartë me vlerë prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë në kapitalin themeltar.


Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjehere nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

NENI 8 ORGANET E SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e përgjithshme;
- Administratori.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese do te rregullohet sipas ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe Statutin e shoqërisë.



**ORGANI ADMINISTRATIV
NENI 9**

Administrator i parë i shoqërisë është **Z. Elgerti Bixha**, pajisur me letërnjoftimin me nr. 035113156.

THEMELUES


SHOQËRIA "FORTIS BETON CO" SHPK

Përfaqësues me Vendimin datë 01.11.2022
të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

Administratori

Z. Ermir Alija

Ermir Alija



Z. ELGERTI BIXHA

Elgerti Bixha